



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

*E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

Ju falenderoj për ftesën për të prezantuar përpara jush Raportin Vjetor për vitin 2021 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Viti 2021 vijoi të ishte një vit sfidues për ekonominë dhe tregjet financiare, si pasojë e ndikimeve nga rikthimi i valës së pandemisë. Megjithatë, ekonomia shënoi rritje, ndërkohë që tregjet financiare u shfaqën rezistentë, pas disa ngjarjeve të paprecedenta të njëpasnjëshme, siç ishte tërmeti, pandemia dhe së fundmi efektet e konfliktit mes Rusisë dhe Ukrainës. Gjatë vitit të kaluar, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit shënuan rritje, si në nivel të ardhurash, sa i përket primeve të sigurimeve, ashtu edhe në aktive sa i përket fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private. Në fund të vitit 2021, totali i asetëve në këto tregje arriti në rreth 128 miliardë lekë, me një rritje prej afro 16% krahasuar me një vit më parë.

Tregu i sigurimeve dhe ai i pensioneve private kanë vijuar trendin rritës edhe gjatë muajve të parë të vitit 2022, ndërsa konstatohet një rënie e lehtë sa i përket asetëve të fondeve të investimit, ndikuar nga luhatshmëria e tregjeve ndërkombëtare për shkak të zhvillimeve të fundit gjeopolitike. Megjithatë, ekspozimi i fondeve tona të investimit ndaj këtyre tregjeve mbetet i kufizuar dhe po monitorohet në vijimësi nga Autoriteti. Bordi i AMF miratoi në muajin prill një udhëzim të posaçëm, ku u kërkohet shoqërive administruese të tregojnë kujdes të shtuar dhe të marrin një sërë masash përkundrejt ndikimeve që vijnë nga mjedisi i jashtëm.

Në një vlerësim të përgjithshëm, tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit paraqiten me tregues të mirë të likuiditetit, të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të mbulimit me provigjone.

Viti 2021 ishte një vit i rëndësishëm sa i përket riformatimit të bazës ligjore e rregullatore të tregjeve nën mbikëqyrje. Avancimet ligjore u vlerësuan edhe në Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Në veçanti, aty është përmendur miratimi i Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili është vlerësuar në përputhje me Direktivat e BE-së. Në raport janë evidentuar edhe ligjet e reja të miratuara për tregjet e kapitalit, për sipërmarrjet e investimeve kolektive, si edhe për tregjet financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë, shoqëruar me aktet përkatëse nënligjore të miratuara nga Autoriteti. Siç theksohet edhe në konstatimet e Komisionit Evropian, këto akte përafrojnë më tej kuadrin ligjor të Shqipërisë me Direktivat Evropiane dhe në këtë kontekst gjej rastin t’ju falenderoj për mbështetjen në miratimin e këtyre ligjeve të rëndësishme. Autoriteti, në vijim

të përafrimit me Direktivat Evropiane, ka hartuar projektligjin e ri “Për fondet e pensionit privat”, i cili është aktualisht në fazën e konsultimit ndërinstitucional.

Në kuadër të procesit të integritimit, si institucioni drejtues i kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, Autoriteti ka realizuar koordinimin, raportimet dhe takimet e posaçme në nënkomitete si dhe ndjekjen e realizimit të planit kombëtar të integritimit për këtë kapitull.

Për t’u veçuar është aderimi së fundmi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në funksion të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve. Kjo është realizuar pas një procesi rigoroz të verifikimit të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS.

Gjithashtu, Autoriteti në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve po realizon një vlerësim të progresit të bërë në lidhje me Parimet Themelore Ndërkombëtare në fushën e sigurimeve (Insurance Core Principles – ICP). Ky proces, ku Autoriteti po asistohet nga ekspertët e Bankës Botërore, synon të sjellë një avancim të mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse dhe rregullative drejt standardeve më të mira ndërkombëtare.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në vijim po jap më shumë detaje sa i përket ecures së tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe impaktin që kanë dhënë ligjet e reja.

Tregu i sigurimeve, në nivel primesh, në vitin 2021, shënoi një rritje me 16%, krahasuar me vitin 2020, duke arritur në rreth 19.3 miliardë lekë. Rritje ka patur edhe krahasuar me periudhën e para-pandemisë, vitin 2019, me 9.4%. Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve vlerësohet në rreth 41 miliardë lekë, me një rritje prej 11% të nivelit të aktiveve likuide, krahasuar me fundvitin 2020. Gjithashtu ka një përmirësim të mëtejshëm të provigjoneve me rreth 5%, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në vlerën e 22 miliardë lekëve në nivel tregu. Edhe aktiviteti i risigurimit ka shënuar rritje. Krahasuar me vitin 2020, ka një rritje me 6.24% të primeve të ceduara në risigurim në nivel tregu, për shkak të rritjes së primeve të shkruara bruto. Cilësia e risiguresve kryesorë të marrëveshjeve me shoqëritë e sigurimit rezulton së paku në kategorinë e vlerësimit A, edhe më e lartë nga kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Ligji për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, në fuqi prej korrikut të vitit të kaluar, ka sjellë ndryshime të rëndësishme, si në aspekt të rritjes së masës së dëmshpërblimit për disa kategori dëmsh, rritje e cila do të jetë progresive edhe përgjatë viteve në vijim, ashtu edhe sa i përket mirëpërcaktimit të afateve dhe procedurave për trajtimin e dëmeve, duke reduktuar kohën e trajtimit dhe pagesave të dëmeve. Janë adresuar problematikat e vërejtura ndër vite me Fondin e Kompensimit, ku është parashikuar edhe mundësia e pagesës së kësaj kategorie dëmsh nga siguresi i drejtpërdrejtë. Gjithashtu, Autoriteti në zbatim të kërkesave të ligjit, ka miratuar rregulloren që kufizon komisionet e ndërmjetësimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm, e cila hyri në fuqi në fillim të këtij viti, duke sjellë ulje të ndjeshme të komisioneve për ndërmjetësit, si edhe reduktim të shpenzimeve të marrjes në

sigurim nga shoqëritë e sigurimit. Risi e ligjit është edhe aplikimi për herë të parë në Shqipëri i praktikës së njohur si Raporti Evropian i Aksidenteve.

Tregu i fondeve të investimeve e mbylli vitin 2021 me një total asetesh neto prej 81.9 miliardë lekë, me një rritje prej 21.5% krahasuar me vitin 2020. Rritje u shënua gjithashtu edhe sa i përket numrit të anëtarëve pjesëmarrës në këto fonde.

Ligji i ri për sipërmarrjet e investimeve kolektive ka shtuar më tej mbrojtjen e investitorit, përmes rritjes së kërkesave për transparencë dhe dhënies së informacioneve shpjeguese nga shoqëritë. Gjithashtu janë rritur kërkesat për kapital dhe për menaxhimin e rrezikut nga ana e shoqërive administruese të investimeve kolektive. Duke parashikuar për herë të parë krijimin e formave të reja të fondeve, si edhe zhvillimin e atyre ekzistuese, ligji i ri ka sjellë rritje të kërkesës, si edhe të numrit të subjekteve që operojnë aktualisht në treg. Gjithashtu, ligji për herë të parë, përmes rregullores së njohjes, ofron mundësinë e marketimit dhe shitjes në Shqipëri të fondeve të licencuara në vendet e Bashkimit Evropian.

Për shkak të kërkesave ligjore, shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, fondet e investimeve dhe depozitarët e tyre iu nënshtruan një procesi rigoroz përputhshmërie. Autoriteti mori në shqyrtim standardet e qeverisjes së brendshme, procedurat administrative dhe kontabël për vlerësimin e riskut, sistemet që mbulojnë aktivitetin e shoqërisë administruese dhe masat mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, si edhe përmbushjen e të gjitha kërkesave për përshtatshmërinë dhe aftësinë e personave dhe personelit kyç.

Tregu i fondeve të pensioneve private, edhe pse me peshë modeste ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, gjatë vitit 2021 shënoi një rritje të mëtejshme si në vlerë asetesh, ashtu edhe në numër anëtarësh. Projektligji i ri, i përafuar me Direktivën Evropiane IORP II, parashikon të vendosë standarde më të larta mirëqeverisjeje, të krijojë mundësinë e formave të reja të fondeve të pensioneve, siç janë ato me pjesëmarrje të mbyllur, të parashikojë një ulje të nivelit tavan të tarifës së administrimit dhe dhënien e lehtësive fiskale, me qëllim stimulimin e zhvillimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Sa i përket **tregut të kapitaleve**, tashmë baza ligjore dhe infrastruktura e tregtimit dhe pastregtimit është e kompletuar. Aktualisht tregu i kapitaleve përbëhet nga tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare, që është edhe segmenti më i madh dhe aktiv, si edhe tregu i obligacioneve me ofertë private. Potencialet për zhvillimin e këtij tregu mbeten të larta, por kjo kërkon angazhimin e shumë pjesëmarrësve dhe institucioneve me rol kyç në këtë treg. Për këtë arsye Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, po hartojnë një dokument strategjik me synim zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Ligji i ri për tregjet e kapitalit, në përputhje me Direktivën MIFID II të Bashkimit Evropian, ka vendosur standarde të larta licencimi dhe mbikëqyrjeje për subjektet, si edhe ka krijuar mundësi të reja për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Në këtë mënyrë, ligji ka krijuar për herë të parë mundësinë e ofrimit të shërbimeve të reja të investimit, krahas atyre tradicionale. Disa nga bankat kanë zgjeruar

shërbimet e ofruara për klientët, duke përfshirë këshillimin e investimeve, administrimin e portofoleve individuale apo nënshkrimin e titujve (*underwriter*).

Gjithashtu për herë të parë është krijuar mundësia e ndërlidhjes së drejtpërdrejtë me tregjet globale, edhe përmes zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare që u ofrohen investitorëve. Ligji ka rritur kërkesat për subjektet që operojnë në këtë treg, në funksion të mbrojtjes më të mirë të klientit. Po ashtu, në zbatim të kërkesave ligjore, të gjithë operatorët e tregut i janë nënshtruar një procesi përshtatshmërie, duke përfshirë rishikimin dhe përditësimin e rregullave dhe procedurave operacionale, rishikimin e kontratave me klientin, certifikimin e funksionarëve dhe personelit kyç, etj.

Autoriteti i ka kushtuar vëmendje të veçantë proceseve të digjitalizimit, si dhe përmirësimit në vazhdimësi të sistemeve të raportimit, edhe në funksion të rritjes së standardeve të mbikëqyrjes. Vitin e kaluar u mundësua integrimi i plotë i shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik në portalin e-Albania. Tashmë, të gjithë ata qytetarë, që pajisen çdo vit me një kontratë sigurimi TPL ose karton jeshil, kur udhëtojnë jashtë vendit, mund të aksesojnë në kohë reale informacionet e nevojshme, si edhe të marrin një dokument zyrtar me vulë elektronike në lidhje me vlefshmërinë e policës së tyre aktuale të sigurimit, historikun e sigurimit të mjeteve, dëmet që kanë shkaktuar ndër vite, si edhe të njoftohen në kohë për rinovimin e policës së tyre të sigurimit.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Gjatë vitit 2022 dhe në vazhdim, fokusi i Autoritetit do të përqendrohet në:

Miratimin e pjesës së mbetur të rregulloreve në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit, me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore.

Ndjekjen e të gjitha fazave të nevojshme të projektligjit “Për fondet private të pensionit”, si edhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe avancimin me standardet më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.

Finalizimin dhe miratimin e strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, si edhe implementimin e saj në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe aktorët e tjerë të tregut.

Si edhe, monitorimin e kujdesshëm të treguesve kryesorë financiarë me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe shëndetshmërisë së subjekteve në mbikëqyrje.

Në fund, më lejoni të theksoj se Autoriteti do të ndjekë me përparësi dhe do të angazhohet në vazhdimësi për plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit, të shprehura përmes rezolutës që do të miratohet në këtë seancë plenare.

Shumë faleminderit!